

ALTAX OBSERVATORY

BRIEF POLITIKASH

Analizë e Portofolit të Investimeve Publike

Dokumenti i Politikave Prioritare 2026–2028 dhe 2027–2029

AO-RES-26-002 | Prill 2026 | ALTAX, Tiranë

Kodi i dokumentit	ALTAX-AO-RES-26-002
Periudha e analizës	2026–2028 dhe 2027–2029 (DPP)
Burimet kryesore	VKM Nr. 91/2025 dhe VKM Nr. 145/2026
Audienca	Politikëbërës, Kuvend, WB, IMF, BE, BERZH
Gjuha	Shqip (me Executive Summary në anglisht)

1. KONTEKSTI DHE QËLLIMI I ANALIZËS

Ky brief politikash prezanton gjetjet kryesore të raportit ALTAX "Analizë e Portofolit të Investimeve Publike" (AO-RES-26-002), i cili shqyrton portofolin e investimeve publike shqiptare sipas dy Dokumenteve të Politikave Prioritare (DPP): DPP 2026–2028 (VKM Nr. 91/2025) dhe DPP 2027–2029 (VKM Nr. 145/2026). Analiza aplikon metodologjinë e Menaxhimit të Investimeve Publike (PIM) dhe realizon krahasim sistematik dyperiudhash, duke identifikuar problemet strukturore të mbiprogramimit dhe mosndryshimit të maturimit.

MESAZHI KRYESOR

Shqipëria programon investime publike 2.25× mbi kapacitetin e saj financiar real. Portofoli total (16.6 mld €) tejkalon me 9.2 mld € kapacitetin e verifikuar të strategjive sektoriale (~7.38 mld €). Vetëm 36% e vlerës është plotësisht e maturuar dhe e gatshme për zbatim.

2. TRE GJETJET KRYESORE

01

Mbiprogramim sistemik: portofoli është 2.25× mbi kapacitetin real financiar

Strategjitë sektoriale planifikojnë ~7.38 mld €, ndërkohë portofoli total arrin 16.6 mld €. Diferenca prej 9.2 mld € nuk është gabim teknik, por pasqyron stimujt institucionalë për të maksimizuar listat e projekteve, jo për të filtruar sipas fizibilitetit. Kapaciteti historik vjetor i ekzekutimit është ~680 mln €/vit, çka nënkupton se realizimi i portofolit aktual do të kërkonte mbi 20 vjet.

02

Vetëm 36% e vlerës totale është plotësisht e maturuar dhe e gatshme për zbatim

Nga 14.83 mld € të portofolit 2027–2029, vetëm 5.29 mld € i përkasin projekteve plotësisht të maturuara. Blloku "Pjesërisht i maturuar" (42% — 6.24 mld €) mbart riskun kryesor fiskal. Blloku i pamaturuar (22% — 3.30 mld €) kërkon filtrim urgjent. Deri 80% e projekteve janë klasifikuar "prioritet A", pra një inflacion prioritetesh që e bën vendimmarrjen buxhetore pothuajse të pamundur.

03

Sistemi prodhon lista projektsh, jo pipeline të filtruar investimesh

Analiza full-matching e 30 projekteve të njëjta mes dy DPP-ve tregon: 73% asnjë ndryshim statusi, 20% rritje statusi (kryesisht sektor digjital dhe infrastrukturë urbane), 7% ulje statusi (TEC Vlora dhe HVDC Vlorë–Brindisi, si sinjal i qartë i krizës së fizibilitetit energjetik). Transporti dhe energjia dominojnë portofolin (58%), ndërkohë sektorët social, shëndetësor dhe arsimor mbeten rëndë të nënpeshuar (<5%).

3. TË DHËNAT KRAHASUESE: DPP 2026–2028 VS 2027–2029

Treguesi	DPP 2026–28	DPP 2027–29	Ndryshimi
Numri i projekteve	86	121	+35 projekte
Vlera totale zyrtare	11.25 mld €	14.83 mld €	+3.58 mld €
I maturuar plotësisht	16 proj. (2.04 mld €)	48 proj. (5.29 mld €)	+3.25 mld €
Pjesërisht i maturuar	36 proj. (6.56 mld €)	39 proj. (6.24 mld €)	-0.32 mld €
I pamaturuar	34 proj. (2.65 mld €)	34 proj. (3.30 mld €)	+0.65 mld €
Kapaciteti financiar real	~7.38 mld €	~7.38 mld €	Gap: 9.2 mld €

Burimi: DPP 2026–2028 (VKM 91/2025) dhe DPP 2027–2029 (VKM 145/2026); analiza ALTAX, AO-RES-26-002.

4. ANALIZA E TRANZICIONIT TË STATUSIT — 30 PROJEKTE

Lloji i tranzicionit	Projekte	Pesha	Interpretimi
Pa ndryshim (=)	22	73%	Cikël i ngadaltë maturimi; kapacitet i kufizuar implementimi institucional
Rritje statusi (↑)	6	20%	Kryesisht sektori digjital dhe infrastrukturë urbane me financim të aksesueshëm
Ulje statusi (↓)	2	7%	Energji strategjike (TEC Vlora, HVDC): krizë e konfirmuar fizibiliteti

MODELI DIGJITAL — SHEMBULL SUKSESI

Sektori digjital është i vetmi ku rritje e statusit është sistematik. Projekte si zgjerimi i GovNET, digjitalizimi i shërbimeve publike dhe sistemi ITS avancuan nga "Pjesërisht i maturuar" në "I maturuar plotësisht" falë kompleksitetit më të ulët teknik, financimit të aksesueshëm dhe kapacitetit institucional të AKSHI. Ky model duhet replikuar në të gjithë sektorët.

5. REKOMANDIMET KRYESORE TË POLITIKAVE

R1	Vendosja e një tavani fiskal detyrues, ku portofoli total të mos tejkalojë 1.2× kapacitetin financiar të verifikuar të strategjive sektoriale (~8.9 mld €).
R2	Krijimi i dallimit zyrtar midis "Core Projects" (gati për zbatim) dhe "Reserve Pipeline" (ide/koncept), duke hequr rreth 50% të projekteve aktuale nga programimi aktiv.
R3	Lidhja e detyrueshme e çdo projekti me një marrëveshje financimi të verifikuar para përfshirjes në buxhetin vjetor eliminon fenomenin e "wishful pipeline".
R4	Krijimi i një Njësie të pavarur PIM brenda Ministrisë së Financave, e modeluar sipas standardeve SIGMA/OECD, për filtrim aktiv dhe monitorim të portofolit.
R5	Ribalancimi sektorial, pra rritja e peshës së investimeve sociale, shëndetësore dhe arsimore nga niveli aktual <5% drejt 10–15% të vlerës totale të portofolit.
R6	Replikimi i modelit digjital (projektet e sektorit digjital janë kryesisht të maturuara dhe me progres të verifikueshëm) në të gjithë sektorët e tjerë.

KONKLZIONI

Problemi themelor nuk është mungesa e projekteve, por mungesa e filtrimit. Shqipëria ka nevojë urgjente për një PIM Unit të pavarur brenda Ministrisë së Financave, një tavan fiskal ligjërisht detyrues dhe një distinkcion zyrtar midis "Core Projects" dhe "Reserve Pipeline". Këto reforma institucionale, ndikojnë për adresimin e mbiprogramimit që të mos vazhdojë të prodhojë lista ambicioze pa rezultate reale, me kosto të lartë fiskale dhe humbje besueshmërie ndaj partnerëve ndërkombëtarë.